



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

**Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve**

Data: 15.05.2023

Nr: 113

Ora: 13:00

**VENDIM**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR. 29, DATË 12.05.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË  
ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 15.05.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**OBJEKT:** Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj kryetarëve të bashkive Fushë Arrëz, Cërrik, Kukës, Delvinë, Has, Libohovë, Shijak, Vlorë, Kuçovë, Shkodër, Vau Dejës, Devoll, Divjakë.

**BAZË LIGJORE:**

Neni 19, pika 1, shkronja "c" dhe neni 21, pika 1, shkronja "dh" të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

**Rrethanat e çështjes:**

1. Referuar pikës 1, të nenit 79 të Kodit Zgjedhor, *jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, kryetari i bashkisë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, përcakton vendet publike në territorin e bashkisë përkatëse për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike.*
2. Me shkresën nr. 4208 prot., datë 25.04.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve u është drejtuar të gjitha bashkive për përcaktimin e vendeve publike në territorin në juridiksion të tyre, për afishimin e materialeve propagandistike të fushatës elektorale të subjekteve zgjedhore.
3. Në zbatim të udhëzimit nr. 6/2021 "Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore", bashkitë kanë detyrimin të dorëzojnë vendimet e tyre në KQZ.

Nga informacioni i administruar rezulton se 13 (trembëdhjetë) bashki nuk kanë dorëzuar në KQZ vendimet e tyre.

4. Mbi këtë bazë, Komisioneri ka vënë në lëvizje KAS-in me anë një kërkesë, duke kërkuar marrjen e masës administrative gjobë në vlerën 5 000 (pesë mijë) lekë ndaj:
  - Z. Fran Tuci, Kryetar i Bashkisë Fushë Arrëz;
  - Z. Andis Salla, Kryetar i Bashkisë Cërrik;
  - Z. Safet Gjici, Kryetar i Bashkisë Kukës;
  - Zj. Majlinda Qilimi, Kryetar i Bashkisë Delvinë;
  - Z. Adem Lala, Kryetar i Bashkisë Has;
  - Zj. Luiza Mandi, Kryetar i Bashkisë Libohovë;

- Z. Elton Arbana, Kryetar i Bashkisë Shijak;
- Z. Dritan Leli, Kryetar i Bashkisë Vlorë;
- Z. Kreshnik Hajdari, Kryetar i Bashkisë Kuçovë;
- Z. Bardh Spahia, Kryetar i Bashkisë Shkodër;
- Z. Mark Babani, Kryetar i Bashkisë Vau Dejës;
- Z. Eduard Duro, Kryetar i Bashkisë Devoll;
- Z. Fredi Kokoneshi, Kryetar i Bashkisë Divjakë.

5. Seanca e datës 15.05.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të specialistëve të administratës së KQZ-së. Kryetarët e Bashkive të mësipërme, ose përfaqësues të tyre, të njoftuar rregullisht, nuk u paraqitën në seancë.

6. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:

- Kërkesën nr. 29, datë 15.05.2023 të Komisionerit;
- Shkresën nr. 4208, datë 25.04.2023 të Komisionerit drejtuar bashkive “Për caktimin e vendeve publike”;
- Vendimin nr. 466, datë 25.04.2023 të Komisionerit “Për propozimin e sanksioneve administrative ndaj disa kryetarëve të bashkive për mosdorëzimin e vendimit për përcaktimin e vendeve publike në territorin e bashkive përkatëse për afishimin prej subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike”.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

### KAS-i konstatoi:

1. Gjatë periudhës së fushatës, subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë propagandë zgjedhore në çdo mënyrë të ligjshme. Materialet që i shërbejnë subjektit zgjedhor për promovimin e fushatës zgjedhore quhen ‘materiale propaganduese statike’, për të cilat ligji parashikon se duhet të vendosen në vende ose hapësira publike me akses publik. Vendet e afishimit të materialeve propagandistike rregullohet nga Kodi Zgjedhor dhe Udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në nenin 79 të Kodit dhe në nenin 3 të Udhëzimit përcaktohet se: *“Kryetari i bashkisë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, jo më vonë se 35 (tridhjetë e pesë) ditë para datës së zgjedhjeve, përcakton vendet publike në territorin e bashkisë përkatëse për afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore”*.
2. Qartazi, Kodi Zgjedhor ngarkon Kryetarin e Bashkisë me detyrimin për të përcaktuar vendet publike të afishimit të materialeve propagandistike, duke i saktësuar dhe kriteret për caktimin e këtyre vendeve. Ndërkohë, neni 3, pika 8, e Udhëzimit përcakton se Kryetarët i Bashkive duhet të dorëzojnë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vendimet e tyre për vendet e afishimit, brenda 24 orësh nga miratimi i tyre.
3. Në seancën e shqyrtimit të kërkesës, i pyetur nga KAS, Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, shpjegoi se pas verifikimeve të kryera nga administrata e KQZ-së, rezultoi se kryetarët e bashkive që nuk kanë bërë dorëzimin e vendimeve për përcaktimin e vendeve publike të afishimit të materialeve propagandistike, në fakt nuk kanë bërë as caktimin e vendit të afishimeve sikurse e kërkon neni 79 i Kodit Zgjedhor.

4. Moscaktimi i vendeve publike për afishimin e materialeve propagandistike është shkelje e nenit 79, pika 1, të Kodit Zgjedhor, ndërsa mosdorëzimi i vendimeve në KQZ është shkelje e nenit 3, pika 7 të Udhëzimit 6/2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.
5. Në këto kushte, KAS vendosi të pranojë kërkesën e Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ për kryetarët e mësipërm.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja ‘dh’, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, me shumicë votash,

#### **V E N D O S I:**

1. Pranimin e kërkesës nr. 29, datë 12.05.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Vendosjen e sanksionit administrativ gjorbë në vlerën 5 000 (pesë mijë) lekë ndaj:
  - Z. Fran Tuci, Kryetar i Bashkisë Fushë Arrëz;
  - Z. Andis Salla, Kryetar i Bashkisë Cërrik;
  - Z. Safet Gjici, Kryetar i Bashkisë Kukës;
  - Zj. Majlinda Qilimi, Kryetar i Bashkisë Delvinë;
  - Z. Adem Lala, Kryetar i Bashkisë Has;
  - Zj. Luiza Mandi, Kryetar i Bashkisë Libohovë;
  - Z. Elton Arbana, Kryetar i Bashkisë Shijak;
  - Z. Dritan Leli, Kryetar i Bashkisë Vlorë;
  - Z. Kreshnik Hajdari, Kryetar i Bashkisë Kuçovë;

- Z. Bardh Spahia, Kryetar i Bashkisë Shkodër;
- Z. Mark Babani, Kryetar i Bashkisë Vau Dejës;
- Z. Eduard Duro, Kryetar i Bashkisë Devoll;
- Z. Fredi Kokoneshi, Kryetar i Bashkisë Divjakë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, mund të bëhet ankim kundër këtij vendimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i tij.

Ngarkohet administrata e KQZ me njoftimin e këtij vendimi palëve në mungesë dhe me zbatimin e tij.

U shpall sot më datë 15.05.2023.

<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>